

## **Programi i Kuponave**

### **Mekanizmi i ankesës lidhur me vendimin për përfitim**

Të gjitha ankesat në lidhje me vendimin për përfitimin nga Programi i Kuponit i drejtohen Komisionit të Ankesave të MASHTI.

Ankesa, së bashku me çdo dokument përkatës apo shtojcë, duhet të dorëzohet me shkrim në formë elektronike përmes platformës e-Kosova. Parashtrimet duhet të bëhen jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së vendimit fillestar.

Komisioni i Ankesave ka për detyrë të kryej një shqyrtim të plotë të të gjitha ankesave të pranuar. Ai është i mandatuar t'i komunikojë me shkrim aplikantit vendimin e tij nëpërmjet e-Kosova brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të ankesës. Në rastet që përfshijnë raste komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet për 15 ditë shtesë.

### **Mekanizmi i ankesës kundër Institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH)**

Pasi të fillojë Programi, prindërit dhe individë të tjerë të interesuar mund të paraqesin ankesa në lidhje me transportin ose çdo aspekt të punës dhe trajtimit të IEFH-ve në çdo kohë. Ankesat duhet të plotësohen duke përdorur formularin e mëposhtëm të ofruar në të gjitha gjuhët zyrtare. Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: [ankesa.kuponat@rks-gov.net](mailto:ankesa.kuponat@rks-gov.net).

Ankesat do të zgjidhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në rastet që përfshijnë çështje komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.

### **Mekanizmi i ankesave kundër aktiviteteve të Programit**

Individët, grupet dhe komunitetet e tjera që besojnë se janë ndikuar negativisht nga Programi mund të paraqesin një ankesë.

Për të paraqitur një ankesë, ankuesit duhet të plotësojnë formularin e publikuar mëposhtë, të ofruar në të gjitha gjuhët zyrtare. Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: [ankesa.kuponat@rks-gov.net](mailto:ankesa.kuponat@rks-gov.net).

Ankesat do të zgjidhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në rastet që përfshijnë çështje komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.

**Pyetjet në lidhje me procesin e aplikimit dhe çështjet teknike me aplikimin mund të dërgohen në çdo kohë me email: [programiikuponave@rks-gov.net](mailto:programiikuponave@rks-gov.net) dhe numrin e telefonit: 03820065048.** Këto ankesa do të trajtohen nga MASHTI përmes Koordinatorit të Programit në mënyrë të vazhdueshme, jo më vonë se 3 ditë.